# DËSHMI ARKIVI

**A-467691**

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

VERSIONI 1

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Sulm brutal në Brazil/ 31-vjeçarja sulmon njerkun, i nxjerr sytë dhe i pret veshët, më pas ai bie nga ballkoni |
| ADRESA | `https://top-channel.tv/2026/09/25/sulm-brutal-ne-brazil-31-vjecarja-sulmon-njerkun-i-nxjerr-syte-dhe-i-pret-veshet-me-pas-ai-bie-nga-ballkoni/` |
| BURIMI | top-channel.tv |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 25 shtator 2026, 06:41:44 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| LEXUAR NGA FAQJA | 25 shtator 2026, 06:38:00 UTC<br>*Portali nuk e deklaron datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me metodën **text_date**. Dritarja: 25 shtator 2026, 06:37:00 UTC → 25 shtator 2026, 06:39:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund të gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `88956c85ac5f0eeb3b090cd0ff989045679c48205e79db4dfc69a529a93165da` |
| TEKSTI | `c406cbaa6e2c25186c4a8e6cf175a69c05761856afd5fa4bbad41e015fd5f7d0` |
| PAMJA | `07f384c9188fd850742f390198257cd4d8996322085c92e37683990f09ac6a6a` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `d1b93e263bdbd0eebd3f4637f060216855cec78972a43b35169755c505053f62` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `491fbc2f0e2919ed311b022f1b5f92632a55c8ad6fb3d3a6ed9398e35c5643c6` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/d1b93e263bdbd0eebd3f4637f060216855cec78972a43b35169755c505053f62`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

BOTA | TË FUNDIT

# Sulm brutal në Brazil/ 31-vjeçarja sulmon njerkun, i nxjerr sytë dhe i pret veshët, më pas ai bie nga ballkoni

25/09/2026 08:38



**Një ngjarje e rëndë po hetohet nga autoritetet braziliane në Manaus, ku një grua transgjinore 31-vjeçare, Aurora Naomi La Fay, akuzohet se ka sulmuar me dhunë ekstreme njerkun e saj 61-vjeçar brenda apartamentit të tij.**

Sipas raportimeve të "The Sun", 61-vjeçari pësoi dëmtime të rënda në fytyrë dhe sy. Për shkak të plagëve, mjekët u detyruan t'i hiqnin të dy sytë, ndërsa ai humbi edhe të dy veshët.

Autoritetet po hetojnë gjithashtu një pretendim se 61-vjeçari mund të jetë sulmuar seksualisht gjatë incidentit. La Fay e ka mohuar akuzën për përdhunim, ndërsa priten rezultatet e ekzaminimeve mjeko-ligjore.

Pas sulmit, 61-vjeçari thuhet se ka rifituar vetëdijen dhe është përpjekur të largohej nga apartamenti. Pavarësisht se nuk mund të shihte, ai është drejtuar drejt ballkonit, nga ku ka rënë nga kati i tretë mbi çatinë e një ndërtese fqinje.

Zjarrfikësit dhe ekipet e shpëtimit e kanë gjetur pak kohë më vonë dhe e kanë transportuar në spital, ku po merr trajtim për plagët e rënda.

Gjatë marrjes në pyetje, La Fay dyshohet se ka deklaruar se kishte konsumuar marijuanë përpara ngjarjes dhe se kjo i kishte shkaktuar halucinacione. Sipas deklarimeve të raportuara, ajo kishte qëndruar brenda apartamentit të njerkut ndërsa ai ishte larg dhe e kishte sulmuar kur ai ishte kthyer.

Nga ana tjetër, 61-vjeçari ka deklaruar se nuk e mban mend të gjithë incidentin, por kujton se ajo e kishte kafshuar në fytyrë përpara se të largohej nga vendi i ngjarjes.

Kreu i hetimit e ka cilësuar ngjarjen si një "episod dhune ekstreme", duke theksuar rëndësinë e plagëve të marra nga viktima brenda banesës së tij.

Sipas "The Sun", 31-vjeçarja dhe 61-vjeçari njiheshin prej rreth pesë vitesh, ndërsa marrëdhënia mes tyre përshkruhet si e vështirë. Nëna e La Fay ka deklaruar para policisë se kishte pasur probleme në marrëdhënien mes tyre, por se nuk ishte raportuar më parë ndonjë rast dhune.

**Top Channel**

## Bota »








## Kryesore



Mesazhi i presidentit iranian për Trump, Pezeshkian: Ne jemi gati për marrëveshje, SHBA duhet të vendosë për fundin e luftës
07:43

Përshkallëzohet protesta pranë Kuvendit, përplasje mes Policisë dhe protestuesve, tentohet çarja e kordonit
12:54

"Shkova në shtëpi dhe mora thikën"/ Detaje nga vrasja e djeshme në Tiranë, dëshmia e autorit Toni Nake: Cara më bullizonte në mënyrë të vazhdueshme
09:43

Nga bllokimi i rrugës me kamionë, tek tërheqja në male, si ndodhi sulmi i Banjskës
13:23

Franca humbet Konate, Zidane e zëvendëson me futbollistin e skuadrës transalpine U21
13:01

## Më të lexuarat

Top Story/ "Kërkoi ekspertim të telefonit jashtë Shqipërisë", gazetarja Hoxha zbardh detajet nga seanca me dyer të mbyllura, çfarë deklaroi Vlora Hyseni në SPAK

Aksion i policisë në Tiranë, vihen në pranga 8 të kërkuar për krime të rënda, armë, drogë dhe vjedhje

"Dumani përzuri Vlorën nga zyra", Murrizi bën deklaratën e fortë në Top Story: E nxori nga qershori i 2025

"Për ty fik radarët e shtetit"/ Komunikimet Hyseni-Agasi, deputetët e opozitës zbulojnë mesazhet: I thoshte që çunat të veprojnë lirshëm

Masa ndaj Vlora Hysenit, Kryemadhi batuta me gazetarët para gjykatës: I patë si i fik radarët? Dashuria, gjë e madhe

Bllokohen specat dhe açuget/ Jo vetëm perimet, Shqipëria ka probleme edhe me produktet e detit. Bllokohen në Itali

"Goca dhe Gra" rikthehet në ekranin e Top Channel me ndryshime, kush janë moderatoret e sezonit të ri?

"Po si nuk i fiku njeri radarët për mua moj motër", Kryemadhi batuta dhe ironi për Vlora Hysenin: Meta i ndizte se kishte hallin e vendit, puthte...

"Lashë në mes përkthimin e librit të ish-

Mesazhi i presidentit iranian për Trump, Pezeshkian: Ne jemi gati për marrëveshje, SHBA duhet të vendosë për fundin e luftës

25/09 07:43

Papa Leo XIV nis sot vizitën në Francë, pritet nga qindra mijëra besimtarë

25/09 07:20

Shqiponja amerikane për Xi dhe mesazhe për Tajvanin, çfarë ndodhi në takimin mes Trump dhe liderit suprem të Kinës

25/09 07:14

shefit të kundërzbulimit të STAS-it", rrëfimi i Auron Tares: Historia e spiunazhit në Tiranë ia kalon edhe Luftës së Ftohtë

"Burg, burg", një grup protestuesish përplasen me Çuçin dhe bashkëshorten në kafene, si përgjigjet deputeti i PS dhe Delina Fico



Fjalimi i Netanyahut në Asamblenë e Përgjithshme të OKB-së, dhjetëra diplomatë lënë sallën: Nëse ka frikacakë të tjerë të largohen tani

24/09 22:59



"I mbani mend këto?"/ Netanyahu tregon gjatë fjalimit në OKB bombat me të cilat u eliminua udhëheqja e Hezbollahut: Menduan se u rrëzuam kur na sulmuan

24/09 22:45



Aksident i rëndë në Rumani, dy gra nga Mbretëria e Bashkuar humbin jetën pasi furgoni i tyre shtypet nga dy kamionë

24/09 20:46

## Na ndiqni:

Top Channel | @topchannelalbania | @tchbreakingnews | Top Channel

## Video »




"Agjente serbe! Të neveris!", Plas mes Vlora Hysenit dhe Klod Lalës! Dalim video dhe përgjime të reja



Top Channel/ Protesta e 117, organizatorët: tubim në çdo seancë parlamenti



Top Channel/ Revolta ndaj Netanyahut, braktiset salla dhe arrestohen 100 persona



Top Channel/ Alarmi i shërbimeve sekrete: Rusia do sulmojë një vend të NATO-s



Top Channel/ Melania "kunja" për Trump: unë kam jetuar mirë në komunizëm



Top News- Sulmi i ashpër i Netanyahut kundër Erdoganit: Është tiran, po kërcënon Greqinë, por ne...



© Top Channel 2001 - 2026 • Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i përmbajtjes së kësaj faqeje.

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.